



Me datë 04.04.2019
Rahovec

Për/Za/To: Z.Smajl Latifin, Kryetar i komunës së Rahovecit

Nga/Od/From: Ymret Reshiti, Udhëheqësi i personelit të komunës së Rahoveci

Lënda /Svrha/Subjekt/: Raporti i punës për periudhën Janar-Mars 2019

I nderuar Kryetar.

Po iu prezantoj raportin e punës tre mujorin e vitit 2019 , të Njesisë së Personelit të administratës së komunës së Rahovecit.

1. Rekrutimet

Gjatë kësaj periudhe janë shpallur katër (3) konkurse publike –rekrutime të personelit , prej të cilave, një konkurs kanë qenë avancim ndërsa një punësim i jashtëm, si në vijim:

1. Udhëheqës i sektorit për Arsim pranë DKA-s, është emëruar kandidati i suksesshëm.
2. Arkëtar në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa është emëruar kandidati i suksesshëm.
3. Zyrtar për arsimin e mesëm të ulët pranë DKA-s, është në procedim.

Kemi shpallur 9 konkurse për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta dhe janë pranua 9 kandidatë.

Kemi përgatitur tërë dokumentacionin për gjithë kandidatët që aplikojnë për punësim.

2. Pushimet e punëtorëve

-Gjatë kësaj periudhe kohore disa punëtorë kanë shfrytëzuar ditët e mbetura të pushimit vjetor 2018, dhe është hapur shfrytëzimi i pushimit vjetor të vitit 2019.

3. Lëshimi i akteve administrative

-Njësia e Personelit gjatë kësaj periudhe ka hartuar gjithsej 46 shkresa administrative si në vijim: vërtetime, draft vendime, propozim vendime, akt emërimi, informata , kontrata pune, rekomandime, njoftime, kërkesa, raporte dhe shkresa tjera.

4. Tabela me të dhënat statistikore

Të dhënat statistikore të personelit. Njësia e personelit tani i procedon drejtpërdrejt në programin elektronik SIMBNJ sipas kërkesës së MAP-s që bëhet rregullisht.

Njësia e personelit të dhënat statistikore për sektorët e arsimit dhe shëndetësisë i siguron nga zyrtarët e atyre dy sektorëve.

-Administrata komunale ka gjithsej 160 punëtor, pa sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Prej këtyre, 12 pozita janë të lira (10 të shërbyesve civil dhe 2 të stafit teknik).

5. Vlerësimi i punës provuese

-Gjatë kësaj periudhe kohore është bërë vlerësimi i punës provuese të dy (2) punëtorëve, si:

- 1 punëtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme
- 1 punëtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Punëtorëve iu është konfirmuar kryerja me sukses e punës provuese dhe iu është vazhduar marrëdhënia punës.

6. Vijueshmëria e punëtorëve në punë

Punëtorët duhet të respektojnë udhëzimet e përdorimit të kartelave të sistemit të vijueshmërisë në punë. Pritet mbikëqyrje më e madhe nga drejtorët e drejtorive si epror të drejtpërdrejtë të punëtorëve, në mënyrë që ky sistem të ketë sukses.

Secilës drejtori u janë dërguar me kohë raportet mujore të vijueshmërisë në punë të punëtorëve.

7. Transferimeve të punëtorëve -ndryshimet në pozitë

Gjatë kësaj periudhe ka pasur vetëm një transferim të brendshëm. Zyrtari për arsim i DKA-s është transferuar në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në pozitën: Zyrtar për sport.

8. Ndërprerja e marrëdhënies së punës

Gjatë kësaj periudhe një (4) punëtorëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës si pasojë e pensionimit, vdekjes. Punëtorëve që u ka pushuar marrëdhënia e punës janë :

1. Shefqet Cena nga Rahoveci –pensionim
2. Adem Çmega nga Rahoveci-pensionim
3. Zoran Gogič nga Hoça e Madhe -pensionim
4. Qerim Morina nga Dejni-vdekje

9. Trajnimet e nëpunësve civil

Janë ndjekur 3 trajnime .

10. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës

Nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës nuk ka ardhur një asnjë vendim:

Nga KPMSHCK-ja janë kërkuar 5 përgjigje në ankesa dhe dokumentacionet e lëndëve ngase ka pasur 5 ankesa.

11.Të dhënat e Komisioneve të Shërbimit Civil të Administratës komunale për vitin 2018

I. Komisioni Disiplinor

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur vetëm një rast për ndjekje disiplinore dhe Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar lëndën dhe punëtorit i ka shqiptuar masën disiplinore: Transferim në një pozitë tjetër .

II. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 5 ankesa.

3 ankesa janë refuzuar si të pa baza ndërsa 3 ankesa janë aprovuar pjesërisht .

Njësia e personelit i kryen punët e sekretarisë për Komisionin Disiplinor dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, duke i lëshuar shkresat administrative përveç vendimeve, të cilat nuk ka të drejtë.